



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.698/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Muhamet Latifit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar apeli i Muhamet Latifit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për të gjitha subjektet politike dhe për të gjithë kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vendvotimin: VV 1809E/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve nga kutia e votimit për Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel më datë 09.11.2017 në ora 14:45 nga Muhamet Latifit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Podujevë në të cilën thekson se në bazë të rezultateve të skanuara në vendvotimin 1809E/01R votat e PDK-së janë bartë për një rubrikë dhe ato janë vendosur në subjektin OBKD me nr 89 – Balli Kombëtar Demokrat. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë vendvotim PDK kishte 116 vota kurse tani ka mbete me zero 0 – vota dhe se subjekti është dëmtuar për 116 vota dhe se për një asambleist.

Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që kjo ankesë të pranohet si e bazuar dhe ti urdhërohet KQZ-së që të vërtetojë gjendjen e saktë faktike

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me ato për të cilën pretendon pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për të gjitha subjektet politike dhe për të gjithë kandidatët e tyre për vendvotimin 1809E/01R, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

ZL A nr. 698/2017 më datën 12.11.2017



**Kryesuesi i Panelit
Gyltëne Sylejmani**

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.